

# **RREGULLORE**

**PËR LIDHJET E REJA NË RRJETIN E SHPËRNDARJES**

## Permbajtja

PJESA I: KËRKESA TË PËRGJITHSHME	4
1.1 Qëllimi	4
1.2 Autoriteti	4
1.3 Garantimi i lidhjes në Rjetin e Shpërndarjes	4
1.4 Personat që kanë të drejtë të aplikojnë	4
1.5 Kërkesa për Lidhje të re.	4
1.6 Kriteret për vlerësimin e Lidhjes së re apo modifikimin e lidhjes ekzistuese	4
1.7 Lejimi për hyrjen në objekt	5
1.8 Kërkesat teknike për një lidhje të re	5
1.9 Përgjegjësia e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	5
1.10 Përgjegjësia e instalimeve dhe testimit të lidhjes së re	5
1.11 Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike	6
1.12 Menyra e komunikimit	6
1.13 Menyra e Aplikimit	6
1.14 Kërkesa për furnizim me energji elektrike nga dy burime të pavarura.	7
PJESA II: PROCEDURAT E APLIKIMIT PËR NJË LIDHJE TË RE	7
2.1 Procedurat dhe Afatet kohore	7
I. Për lidhje të re në tension të ulët 0-20 kW.	7
II. Për Lidhje të re kur fuqia e instaluar është 21-50 kW.	8
III. Burimet e reja të gjenerimit të energjisë elektrike	11
2.2 Projektimi	13
2.3 Procedura për zhvendosjen e aseteve të OSSH	14
2.4 Menyra e lidhjes në rrjet të burmieve të energjisë	14
PJESA E III: DOKUMENTAT QË KERKOHEN PËR APLIKIM	14
3.1 Dokumentacioni për lidhje të re në tension të ulët fuqi instaluar deri në 20 kW	14
3.2 Dokumentacioni që kërkohet për fuqi të instaluar 21-50 kW.	14
3.3 Dokumentacioni që kërkohet për fuqi të instaluar mbi 50 kW	15
3.4 Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese	15
3.5 Projektimi i kabines së transformatorit.	15
3.6 Vlefshmeria e dokumentacionit të paraqitur	16
PJESA E IV: TARIFAT PËR LIDHJET E REJA	16
4.1 Parimet e tarifave	16
4.2 Punimet shërbimet që do të paguhën nga aplikanti	16
4.3 Menyra e pagesës	17
4.4 Struktura e tarifave të lidhjes së re	17

4.5	Kushtet të tjera për lidhje në rrjetin shpërndarës	18
4.6	Tarifat për lidhje në tension të ulët	19
4.7	Tarifat për lidhje në tension të mesëm	19
4.8	Tarifa për lidhje në tension të mesëm 35 kV	20
4.9	Tarifa për shtesë fuqie	20
4.10	Tarifat për modifikim ose transferim lidhjeje	20
4.11	Tarifat për lidhje në N Stacione	21
4.12	Tarifa për rastet e lidhjes nga disa burime të energjisë elektrike	22
4.13	Tarifa T4 për verifikimi dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike	22
4.14	Tarifa T5 për ndertimi e kabines elektrike	22
4.15	Tarifa lidhjen e burimeve të gjenerimit të energjisë elektrike	22
4.16	Kontrolli i kërkeses maksimale për fuqi	22
<b>PJESA V: PRONESIA PËR LIDHJET E REJA</b>		<b>23</b>
5.1	Kufijte e pronesise	23
5.2	Marreveshja për kalimin e pronesise	23
5.3	Të drejtat e pronesise mbi pasurine e palujtshme	24
<b>PJESA VI: SUBJEKTET E AUTORIZUARA</b>		<b>24</b>
<b>PJESA VII: DISPOZITA PERFUNDIMTARE</b>		<b>24</b>

## **PJESA I: KËRKESA TË PËRGJITHSHME**

### **1.1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike dhe Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes , të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes si dhe të përcaktojnë procedurat, afatet dhe tarifatat për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.

### **1.2 Autoriteti**

Kjo rregullore hartohet bazuar në Ligjin Nr.43 datë31.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, “Kodit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike” miratuar me vendimin nr. 100, date 26.08.2008te Bordit te Komisionereve dhe “Metodologjisë së Llogaritjes të Tarifës të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin nr.79, date 26.06.2008, te Bordit te Komisionereve te ERE-s.

### **1.3 Garantimi i lidhjes në Rrjetin e Shpërndarjes**

Në zbatim të legjislacionit në fuqi, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të siguroje lidhjen në rrjetin e Shpërndarjestë gjithë paleve të interesuara në përputhje me kriteret e percaktuara nëkëtë rregullore.

### **1.4 Personat që kanë të drejtë të aplikojnë**

Aplikimi për Lidhje të re në Sistemin e Shpërndarjes mund të kryhet nga:

- a. Përdoruesit ekzistues të Sistemit tëShpërndarjessë Energjise Elektrike të cilet kerkojne të realizojne një lidhje të re ose të modifikojne lidhjet e tyre ekzisutese në sistemin e Shpërndarjes. (Përdoruesi)
- b. Cdo person fizik apo juridik, i cili aplikon për realizimin e një Lidhje të Re në sistemin e Shpërndarjessë Energjise Elektrike. (Aplikant).
- c. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike nuk do të pranoje kerkesen për Lidhje të re nese Përdoruesi apo Aplikanti rezulton debitor dhe nuk ka shlyer detyrimet e meparshme ndaj Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.

### **1.5 Kerkesa për Lidhje të re.**

Kërkesapër Lidhje të re paraqitet pranë zyrave te Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrikepër:

- a. Lidhje të objekteve (banimi apo biznesi) me Sistemin e Shpërndarjes;
- b. Rritjen e fuqisë së lidhjes ekzistuese;
- c. Kerkesë për lidhje të përkohshme;
- d. Lidhje në Sistemin e Shpërndarjes të burimeve gjeneruese

### **1.6 Kriteret për vleresimin e Lidhjes së re apo modifikimin e lidhjes ekzistuese**

Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike për vleresimin e një aplikimi për Lidhje të re apo modifikim tënjë lidhjeje ekzistuese do të respektoje kushtet dhe rregullat e percaktuara në Kodin e Shpërndarjes si dhe kriteret si vijon:

- a. Percaktimin e Pikës së Lidhjes, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike

do të marre parasysh vendndodhjen e objektit, përtë cilin kërkohet lidhja, afërsia e tij me Sistemin e Shpërndarjes, nivelin e sigurisë së furnizimit, nivelin e rrymes së lidhjes së shkurter si dhe të gjitha aplikimet e tjera për lidhje nëtënjëjtën pike të Rrjetit të Shpërndarjes Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike

- b. Lidhjet e reja apo modifikimet e lidhjes ekzistues nuk duhet të shkaktojnë efekte negative mbi klientet apo Përdoruesit ekzistues dhe as nuk duhet të ndikohen nga efektet negative të klienteve apo Përdoruesit ekzistues.
- c. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të percaktojë kushtet e mënyres së realizimit të lidhjes dhe parametrat teknike të pajisjeve që do të shërbejnë për lidhjen e klienteve të rinj me Sistemin e Shpërndarjes konform standarteve europiane dhe standarteve të vete shoqërisë.

### **1.7 Lejimi për hyrjen në objekt**

Përdoruesit apo Aplikantët që paraqesin kërkesën për Lidhje të re kanë detyrimin që të sigurojnë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike të drejten përtë hyrje në objektet e tyre, duke krijuar lehtësira të nevojshme, në mënyrë që ky i fundit të arrijë të vlerësojë të gjitha kërkesat dhe kushtet për lidhjen e re.

### **1.8 Kërkesat teknike për një lidhje të re**

Të gjitha punimet me karakter ndërtimor, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe pajisjet kryesore të kabinave elektrike (çelatat hyrëse/ dalëse, çelatat e transformatorëve, transformatorët e fuqisë, panelet e Shpërndarjes së tensionit të ulët, kabllot lidhëse me rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulët, etj) do të projektohen, prodhohen, instalohen dhe testohen në përputhje me të gjitha detyrimet ligjore në fuqi dhe do të jenë konform standarteve teknike të cilat janë pjesë e Marrëveshjes së Lidhjes së re.

### **1.9 Përgjegjësia e Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike**

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për:

- a. Përgatitjen e kushteve teknike të lidhjes së re dhe specifikimet teknike të të gjitha pajisjeve që mund të perfshihen në realizimin e lidhjes së re.
- b. Përgatitjen e kostove respektive për çdo mundësi të realizimit të lidhjes së re.
- c. Zgjedhjen e subjekteve të pavarura që do të realizojnë blerjen e pajisjeve të lidhjes së re sipas kushteve dhe specifikimeve teknike të miratuara, realizimin e lidhjes së re dhe testimin e pajisjeve pas instalimit.

### **1.10 Përgjegjësia e instalimeve dhe e testimit të lidhjes së re**

Subjekti i pavarur, i autorizuar nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike është përgjegjës për:

- a. Sigurimin e të gjithë pajisjeve elektrike që lidhen me realizimin e lidhjes së re sipas miratimit të bërë nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike dhe kushteve teknike.
- b. Të gjitha pajisjet elektrike do të jenë të reja dhe do të jenë në përputhje me kushtet teknike bashkangjitur kësaj rregullore.
- c. Instalimin e të gjitha pajisjeve që lidhen me realizimin e lidhjes së re që perfshijnë pajisjet kryesore linjave dhe të kabinave elektrike (çelatat hyrëse dalëse, çelatat e transformatorëve, transformatorët e fuqisë, panelet e Shpërndarjes së tensionit të ulët, kabllot lidhëse me rrjetin e tensionit të mesëm dhe të ulët, etj), sistemin e matjes së energjisë elektrike që perfshin transformatorët e rrymes, transformatorët matës të tensionit, aparatën matës të

energji elektrike etj.

- d. Instalimin e sistemit te tokezimit mbrojtete objektit dhe konsumatoreve te tjere qe furnizohen me energji elektrike nga kjo lidhje e re, ne perputhje me kushtet teknike dhe normat ne fuqi.
- a. Testimin e te gjitha pajisjeve elektrike dhe pregatitjen e raporteve teinspektimit te pajisjeve.

### **1.11 Pergjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike**

- a. Përdoruesi apo Aplikanti është pergjegjes për instalimin e të gjitha pajisjeve mbrojtese nga lidhja e shkurter, ato të mbrojtjes nga lidhja me tokën si edhe pajisjet e mbrojtjes nga mbitensionet (atmosferike, ato të komutimit dhe ato të mbrojtjes nga keputja e percjellesit të neutralit) për cdo konsumator që do të furnizohet me energji elektrike nepermjet lidhjes së re qëkërkohet realizohet.
- b. Për asnje aplikant apo përdorues nuk do dale urdhëri i dhenies tension nese instalimet e brendshme nuk do të kene mbrojtjet e përcaktuarnëkëtë paragraf.
- c. Përdoruesi apo Aplikanti duhet të realizoje sistemin e tokëzimit klienteve te tjere që furnizohen me energji elektrike nga kjo lidhje e re, në perputhje me kushtet teknike dhe normat në fuqi.
- d. Përdoruesi apo Aplikanti duhet të garantoje sëtë gjitha instalimet elektrike nëtë gjithë objektin qëkërkohet furnizohet me energji elektrike janë kryer, inspektuar dhe provuar nga njësubjekt i pajisur me licence për projektimin dhe instalimin e pajisjeve elektrike në perputhje me rregullat dhe kushtet teknike në fuqi.
- e. Përdoruesi apo Aplikanti do të marre persiper të cliroj nga cdo lloj pergjegjesie Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike për cdo lloj detyrimi që lidhet me demtime të cdo lloji të rrjetit shpërndarëstë shkaktuara prej instalimeve të brendshme të pajisjeve elektrike në objektin që kerkohet të lidhet me energji elektrike.

### **1.12 Menyra e komunikimit**

Si forme e pergjithshme komunikimi do të jete ajo me shkrese zyrtare e shoqeruar me numrin respektiv të protokollit. Gjatë hapave të ndryshem të zbatimit të procedurave mund të pranohet edhe komunikimi me email midis paleve për efekt tëshkëmbimit vetem të njoftimeve për perfundimin e disa hapave konkrete sikurse janëtëpërcaktuarnëkëtë Rregullore.

### **1.13 Menyra e Aplikimit**

- a. Aplikimi për lidhjen e re do të behet sipas Formularit të Tip të Aplikimit dhe do të kryhet:
  - Për fuqi të instaluar nga 0-20 kW pranë zyrave të Kujdesit të Klientit teOperatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, nëZonën e banimit të aplikantit.
  - Për fuqi të instaluar nga 21 deri në 50 kW:
    - Për lidhjet në TU, pranë Zyrave të Kujdesit të Klientit Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike , nëZonën e banimit tëaplikantit.
    - Për lidhjet në TM, pranë Zyrave të Kujdesit të Klientit te Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, në Drejtorine Rajonale që mbulon rrjetin shpërndarësnëzonën e banimit të aplikantit.
- b. Aplikimi per lidhjen e re për fuqi të instaluar me shumë së 50 kW do të behet pranë Zyrave të Kujdesit të Klientit te Operatori i Shperndarjes te Energjise

Elektrike, në Drejtorine Rajonale që mbulon rrjetin shpërndarësnëzonën e banimit të aplikantit.

- c. Detajet e vend ndodhjes së Zyrave të Kujdesit ndaj Klientit si dhe informacion mbi Formularin Tip që do të perdoret përtë aplikuar për Lidhje të re si dhe dokumentacionin e plotëqë lidhet me kerkesat dhe kushtet teknike që duhet të respektohen përtë projektuar dhe realizuar Lidhjen e re, në cdo rreth mund të gjenden në adresen perkatese të internetit te Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.[www.oshee.al](http://www.oshee.al)

#### **1.14 Kerkesa për furnizim me energji elektrike nga dy burime të pavarura.**

Operatori i Sistemit tëShpërndarjes do të vleresoje kerkesen për Lidhje të re me energji elektrike të objektit nga dy burime të pavarurua tëenergjisë elektrike, në perputhje me Rregullat e Shfrytëzimit dhe Operimit të Sistemit tëShpërndarjes. Tarifat respektive për keto raste paraqiten në Pjesen e IV- Tarifat.

## **PJESA II: PROCEDURAT E APLIKIMIT PËRNJË LIDHJE TË RE**

### **2.1 Procedurat dhe Afatet kohore**

#### **I. Për lidhje të re në tension tëulët 0-20 kW.**

- a. Për rastet kur fuqia e instaluar e kerkuar nga Aplikanti përnjë Lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, është 0-20 kW, nuk kërkohettënëshkruhet paraprakisht “Marrëveshjepër Lidhjen e re”
- b. Afati i realizimit të Lidhjes së re për keto raste do të jete:
  - Jo me shumësë 5 dite pune për fuqi të instaluar deri në 10 kw.
  - Jo me shumësë 10 dite pune për fuqi të instaluar 10-20 kw.
- c. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do tëinspektojë objektin qëkërkon lidhjen me energji elektrike dhe do të kryeje miratimin e pikes dhe menyres së lidhjes në rrjet.
- d. Nese realizimi i lidhjes së re kërkon me shumësë 50 ml kabell koaksial apo pajisje të tjera (shtylla, punime civile etj) atëherë aplikanti është pergjegjes përshpenzimet shtese qe lidhen me realizimin e punimeve shtesëtë kabllit koaksial me shumësë 50 ml.
- e. Pas kryerjes nga aplikanti të pageses së tarifes së lidhjes së re së bashku me shpenzimet e tjera, pregatitet urdhëri për vendosjen e aparatit matës (boks individual me matës perfshi 50ml kabell koaksial dhe elektrode tokëzimi). Sistemi i matjes sëenergjisë duhet të instalohet brenda 2 diteve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes.
- f. **Paisjet e lidhjes se re sigurohen, instalohen dhe testohen nga subjekti i pavarur i autorizuar nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike duke zbatuar rigorozikisht specifikimet teknike te saj.** Verifikimi i matesit te energjise elektrike realizohet nga subjekti i pavarur per verifikimin e matesave te energjise elektrike. Test raporti i verifikimit te matesit elektrik i dorezohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike
- g. Lidhja nen tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet nëtënjëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.
- h. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike regjistron lidhjen e re ose modifikimin e kryer për aplikantin, klientin apo Përdoruesin në sistemin e tij të

klienteve dhe përgatit kartelen e furnizimit të tij së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 3 diteve pune pas vëniesnë tension.

- i. I gjithë informacioni i lidhjes së re si dhe kontrata e furnizimit të abonentit ruhet nga kompania OSHEE në menyre elektronike dhe dokumentare.

## **II. Për Lidhje të re kur fuqia e instaluar është 21-50 kW.**

- A. Për rastet kur fuqia e instaluar përnjë Lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese, është 21-50 kW, në tension tëulët procedurat dhe afate kohore do të jenë ato të percaktuara në Piken 2.1.
- B. Për rastet kur fuqia e instaluar përnjë Lidhje të re ose për modifikimin e një lidhjeje ekzistuese është 21-50 kW, në tensionin e mesëm duhen të plotësohen procedurat dhe afatet si me poshte:
  - a. Për rastet kur nuk parashikohet ndertimi i kabines së re elektrike, atëherë nuk do kërkohet nënshkruhet paraprakisht "Marreveshje për Lidhjen e re".
  - b. Periudha e realizimit të lidhjes së re për keto raste do të jete jo me shumësë 15 dite pune prej dites së miratimit të "Marreveshje për Lidhjen e re".
  - c. Nëse realizimi i lidhjes së re kërkon me shumësë 50ml kabell (koaksial ose kabell PVC) apo pajisje të tjera (shtylla, punime civile etj) atëherë Përdoruesi apo aplikanti është përgjegjes për shlyerjen paraprake të detyrimeve për gjatesine shtesëtë kabllit me shumësë 50 ml.
  - d. Pas kryerjes nga aplikanti të pageses së tarifës së lidhjes dhe shlyerjes së detyrimeve të tjera, përgatitet urdhëripër vendosjen e aparatit matës (boks individual me matës perfshi 50ml kabell koaksial dhe elektrode tokëzimi). Sistemi i matjes së energjisë duhet të instalohet brenda 2 diteve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes
  - j. Paisjet e lidhjes se re sigurohen, instalohen dhe testohen nga subjekti i pavarur i autorizuar nga Operatori i Shpërndarjes te Energjisë Elektrike. Verifikimi i matesit te energjisë elektrike realizohet nga subjekti i pavarur per verifikimin e matesave te energjisë elektrike. Test raporti i verifikimit të matesit elektrik i dorezohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Shpërndarjes te Energjisë Elektrike
  - k. Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet në të njëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.
  - l. Në rast së gjatë vëniesnë tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen (të instaluar nga subjekti i pavarur i autorizuar nga Operatori i Shpërndarjes te Energjisë Elektrike) atëherë subjekti është i detyruar me shpenzimet e tij të riparoj pjesen e demtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotëtë funksionoj normalisht.
  - m. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes regjistron Përdoruesin apo Aplikantin në sistemin e tij të klienteve dhe përgatit kartelen e furnizimit të tij së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 2 diteve pune pas vëniesnë tension. Operatori i Sistemit ve në dispozicion të subjektit të autorizuar informacionin e nevojshem për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.
- C. Procedurat dhe Afatet kohore për Lidhje të re ose për modifikim të një lidhjeje ekzistuese kur fuqia e instaluar është mbi 50 kW.
  - a. Përdoruesi apo Aplikanti duhet të paraqese projektin elektrik të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike. Ky projekt duhet të ketë të pasqyroje të gjitha detajet konstruktive dhe menyren e realizimit të instalimeve



të brendshme të tij duke u shoqeruar me relacionin teknik perkates përtë treguar të gjitha ngarkesat elektrike dhe menyren e vendosjes së tyre brenda objektit. Projekti duhet te respektoje kushtet teknike te lidhjes se re qe jane pjese e kesaj rregullore. Ky projekt duhet te jete i realizuar dhe perlllogaritur nga nje kompani e licensuar per projektme elektrike.

- b. Për rastet kur parashikohet ndertimi i kabines së re elektrike atëherë do kërkohet nënshkruhet paraprakisht “Marrëveshje për lidhjen e re”
- c. Periudha e vleresimit prej Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike të kerkeses së bere nga Përdoruesi apo Aplikanti dhe paraqitja për pranim dhe nenshkim i Propozimit për lidhjen dhe “Marrëveshjes së Lidhjes së Re” nuk do të jete jo me shumësë 20 dite pune prej dites së paraqitjes së aplikimit.
- d. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të kryhej paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga Përdoruesi apo Aplikanti dhe nësë aplikimi nuk është i plotë atëherë Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të njoftoj Përdoruesin apo Aplikantin me shkrim brenda 5 diteve pune që nga data kur aplikimi është dorezuar për vleresim.
- e. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe, në varesi të gjendjës së rrjetit elektrik në atë zonë, do të pregatise menyren e lidhjes së objektit në rrjet. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të përgatisë Propozimin dhe Marrëveshjen për Lidhjen e re dhe do t’ja dërgojë aplikantit për pranim.
- f. Propozimi për lidhjen e re, i pergatitur nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, mund të pranohet nga aplikanti jo me vone së pese (5) dite pune nga data që Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike e ka vendosur propozimin e tij në dispozicion të aplikantit.
- g. Nëse propozimi është parashikuar që lidhja e re të kryhet në tensionin e ulët dhe aplikanti e pranon propozimin atëherë aplikanti duhet të paguaje detyrimet perkatese brenda 5 dite pune nga njoftimi i propozimit të bere perndryshe propozimi behet i pavlefshem dhe ai duhet të aplikoj perseri për lidhje të re.
  - Nëse realizimi i lidhjes së re kërkon me shumësë 50 ml kabell (koaksial ose kabel PVC sikurse parashikohet në miratimin e pikes së lidhjes) apo pajisje të tjera (shtylla, punime civile etj) atëherë aplikanti është pergjegjes për shlyerjen paraprake të detyrimeve për gjatesine shtesë të kabllit me shumësë 50 ml.
  - Pas kryerjes nga aplikanti te pageses së tarifes së lidhjes dhe shlyerjes së detyrimeve të tjera dhe inspektimit brenda 1 dite pune nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, pergatitet urdhëripër vendosjen e aparatit matës (boks individual me matës perfshi 50 ml kabell koaksial dhe elektrode tokëzimi). Sistemi i matjes së energjisë duhet të instalohet brenda 2 diteve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes. Lidhja nën tension dhe furnizimi me energji elektrike do të realizohet në të njëjtën kohë me vendosjen e aparatit matës.
  - Pajisjet e lidhjes se re sigurohen, instalohen dhe testohen nga subjekti i pavarur i autorizuar nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike. Verifikimi i matesit te energjise elektrike dhe bashkevulosja e terminaleve te matesit elektrik realizohet nga subjekti i pavarur per verifikimin e matesave te energjise elektrike. Test raporti i verifikimit te matesit elektrik i dorezohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike
  - Në rast së gjetëvënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që

- realizuan lidhjen atëherësubjekti i autorizuarështë i detyruar me shpenzimet e tij të riparoj pjesen e demtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotët funksionoj normalisht.
- Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike regjistron aplikantin, klientin apo Përdoruesin në sistemin e tij të klienteve dhe përgatit kartelen e furnizimit të tij së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 2 diteve pune pas vëniesnë tension.
- h. Nësenë Propozimin dhe Marrëveshjen e Lidhjes së Re është parashikuar lidhja e energjisënë tensionin e mesëm dhe aplikanti pranon propozimin atëherë
- Aplikanti dorëzonteOperatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike formularin e pranimit të Propozimit dhe Marrëveshjen e lidhjes së re të nënshkruar.
  - Brenda 2 diteve të punes nga kryerja e pageses, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të përgatise urdhërin administrativ për fillimin e projektit në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të paraqitura nëMarrëveshjen e lidhjes dhe ja dorëzon subjektit të autorizuar që do të kryej levrimin, instalimin, kolaudimin dhe testimin e pajisjeve të lidhjes së re dhe do të realizoj tokezin mbrojtës të kabines transformuese.
  - Pas dorëzimit të projektit të detajuar të objektit Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike duhet të analizoje atë, dhe nëse projekti është në përputhje me kushtet teknike, brenda 2 diteve pune Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të miratojë projektin dhe njoftoj subjektin e autorizuar dhe aplikantin për të kryer tëplotë pagesen e tarifës për lidhjen e re. Nëse aplikanti nuk kryhen pagesen e tarifës brenda 2 diteve të punes prej momentit të miratimit dhe njoftimit të tij prej Operatorit të Shperndarjes te Energjise Elektrike të mënyrës së lidhjes së tij në tensionin e mesëm të rrjetit shpërndarës atëherë aplikimi dhe marrëveshja e lidhjes së re do të konsiderohen të pavlefshme dhe ai duhet të aplikoj përseri për lidhje të re.
  - Pas pageses së tarifës së re nga ana e aplikantit, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të nxjerrë menjëherë lejen për fillimin e punimeve. Punimet do të kryhen nga subjekti i pavarur i autorizuar nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
  - Në rastet kur kabina elektrike si pasuri e paluajtshme është ndërtuar nga aplikanti brenda objektit godines e/i cili/a do të furnizohet me energji, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, do të japë aprovimin që ambjenti i përshtatur për kabine, është brenda kushteve teknike dhe e aksesueshme në ta. Menjëherë pas aprovimit subjekti i autorizuar prej Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, do të kryejë punimet për instalimin e pajisjeve elektrike.
  - Pajisjet e lidhjes së re sigurohen, instalohen dhe testohen nga subjekti i pavarur i autorizuar nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
  - Pas përfundimit të punimeve nga ana e subjektit të autorizuar nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, subjekti do të njoftoj Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike për kryerjen inspektimit përfundimtar dhe nëse punimet janë kryer në përputhje me kushtet teknike atëherë brenda 1 dite pune Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të kryejë pranimin dhe lejojë vendosjen në tension të pajisjeve e pajisjeve. Nëse gjatë kontrollit konstatohen të meta teknike atëherësubjekti

- autorizuara nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike është i detyruar të perfundoje apo korrigjije të metat e konstatuara.
- Pas perfundimit të instalimeve, subjekti i autorizuar njofton me shkrim Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike dhe brenda 2 diteve pune Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike është i detyruar të inspektojë dhe të marre në dorezim kabinen elektrike nepermjet një proces verbali të vecante. Nëse do të konstatohen të meta atëherë ato do të riparohen nga subjekte të autorizuara nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
  - Pas marrjes në dorezim të kabines elektrike, brenda 1 dite pune Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike përgatit raportin e vendosjes së sistemit të matjes (matësa, bokse kolektive, etj) së energjisë elektrike i cili duhet të instalohet brenda 5 diteve pune nga dita e nxjerrjes së raportit të matjes
  - Verifikimi i matesit te energjise elektrike realizohet nga subjekti i pavarur per verifikimin e matesave te energjise elektrike. Test raporti i verifikimit te matesit elektrik i dorezohet nga subjekti i pavarur tek klienti dhe Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
  - Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike përgatit urdhërin e vënies nen tension të pajisjeve. Prova dhe venia nen tension pajisjeve do të kryhet brenda 1 dite pune dhe do të kryhet nga strukturat përgjegjese të Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
  - Në rast sëgjatëvënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen atëherë subjekti i autorizuar është i detyruar me shpenzimet e tij të riparoj pjesen e demtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotët funksionoj normalisht.
  - Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike regjistron aplikantin, klientin apo Përdoruesin në sistemin e tij të klienteve dhe përgatit kartelen e furnizimit të tij tyre së bashku me kontratën e furnizimit me energji elektrike brenda 5 diteve pune pas vënies në tension. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike ve në dispozicion të subjektit të autorizuar informacionin e nevojshem për lidhjen e re ose modifikimin e lidhjes së kryer.
  - Afatet e realizimit të lidhjes së re do të jenë 50 dite të ndara sipas hapave:
    - Jo me shume se 20 dite për procedurën e aplikimit në Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, kontrollin e aplikimit nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, identifikimin e pikes së lidhjes, përgatitjen e dizajnit dhe llogaritjen e shpenzimeve.
    - Jo me shume se 25 dite për marrjen e lejeve perkatese dhe realizimin e të gjitha punimeve ndertimore nga subjekti i autorizuar nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike
    - Jo me shume se 5 dite për instalimin e sistemit të matjes.

### **III. Burimet e reja të gjenerimit të energjisë elektrike**

Aplikimi për lidhje të re për burime të reja të gjenerimit në rrjetin e Tensionit të Mesëm me fuqi të instaluar me shumësë 50 kW do të behet pranë zyrave të Kujdesit të Klientit te Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, në Tirane.

- a. Periudha e vlersimit të kërkeses së bere nga aplikanti dhe paraqitja përnenshkrim e “Marrëveshjes së Lidhjes së Re” nuk do të jete jo me shumësë 20 dite pune prej dates së paraqitjes së aplikimit.
- b. Aplikanti duhet të paraqese projektin elektrik të Burimit të gjenerimit që kerkohet të lidhet me rrjetin e Shperndarjes. Ky projekt duhet të pasqyroje të

- gjitha detajet teknike dhe parametrat kryesore të pajisjeve së bashku me skemen principale të tij.
- c. Aplikanti do të paraqese projektin e lidhjes elektrike të burimit të gjenerimit me Sistemin e Shpërndarjes pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Lidhjes së re, nepermjet urdhërit për fillimin e projektimit që do të nxirret nga Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike.
  - d. Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të kryeje paraprakisht verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti dhe nëse aplikimi nuk është i plotë atëherë Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të njoftoj aplikantin me shkrim brenda 5 diteve të punes prej dates kur aplikimi është dorëzuar për vlerësim.
  - e. Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të inspektojë objektin që kërkon lidhjen me energji elektrike dhe në varesi të gjendjes së rrjetit elektrik në atë zonë do të pregatise menyren e lidhjes së objektit në rrjet. Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të pregatise propozimin dhe Marrëveshjen për Lidhjen e re dhe do t'ja dërgojë aplikantit për pranim.
  - f. Nëse aplikanti bie dakort me propozimin paraqitur nga Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike për t'u lidhur në sistemin e tij të Shpërndarjes, ai duhet të firmose formularin e pranimit të propozimit dhe Marrëveshjen e Lidhjes së re brenda afatit prej 10 ditësh kalendarike. Në rast të kundërt propozimi dhe marrëveshja behet e pavlefshme dhe kërkesa për lidhje të re duhet të perseritet.
  - g. Nëse aplikanti pranon propozimin atëherë ai dorëzon formularin e pranimit të propozimit dhe nënshkruan dhe e dorëzon Marrëveshjen e lidhjes së re tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes. Brenda 2 diteve pune Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të pregatise lejen për fillimin e projektit në përputhje me kërkesat dhe kushtet teknike të paraqitura në Marrëveshjen e lidhjes. Në këto kushte është saktësuar që në pikën e lidhjes me rrjetin tone duhet të vendosen sistemi i matjes si dhe mbrojtjet perkatëse, me qëllim që për çdo defekt në burimin e energjise ose në linjen transmetuese të mos sjelle ndërprerje në konsumatorët e tjere bazuar edhe në Nenin I pika 1.6 b të po kësaj rregulloreje.
  - h. Pas dorëzimit të projektit të detajuar Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike duhet të analizoje atë dhe nëse projekti është në përputhje me kushtet teknike atëherë brenda 2 diteve pune Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të miratoje projektin dhe do të njoftojë aplikantin për kryerjen e pageses së plotë të tarifës për lidhjen e re. Nëse aplikanti nuk kryhen pagesen e tarifës brenda 10 diteve kalendarike prej momentit të miratimit të menyres së lidhjes së tij në rrjetin shpërndarës atëherë aplikimi dhe marrëveshja e Lidhjes së re do të konsiderohen të pavlefshme dhe i interesuari do të duhet të aplikojë perseri për lidhje të re.
  - i. Pas pageses së tarifës së lidhjes së re nga ana e aplikantit Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të nxjerre menjëherë lejen për fillimin e punimeve.
  - j. Të gjitha punimet dhe pajisjet e në burimin e energjise do të realizohen nga aplikanti duke zgjedhur ai subjektin që do të kryej instalimin e pajisjeve dhe komponenteve të lidhjes së re. Instalimi i pajisjeve në N/stacionet elektrike në pronësi të Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike dhe të gjitha linjave të furnizimit me energji elektrike do të kryen nga subjektet e pavarura të autorizuar nga në tension të mesëm që lidhen me linjen e furnizimit me

- energji elektrike.
- k. Pas perfundimit të punimeve dhe instalimeve aplikanti dhe subjekti i autorizuar njofton me shkrim Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike dhe brenda 2 diteve pune Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike është i detyruar të inspektojë dhe të marrë në dorezim punimet dhe instalimet e kryera nepermjet një proces verbali të vecante. Nëse do të konstatohen të meta atëherë ato do të riparohen nga ana e aplikantit ose subjektit te autorizuar.
  - l. Aplikanti bashkepunon me bleresin e energjisë elektrike përtë realizuarvendosjen e sistemit të matjes së energjisë elektrike në pikën e lidhjes me sistemin e shperndarjes, në perputhje me kerkesat e Kodit të Matjes. (I cili duhet ndryshuar).
  - m. Pas vendosjes së sistemit të matjes, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike pergatit urdhërin e vënies nën tension të pajisjeve. Prova dhe venia nën tension pajisjeve do të kryhet brenda 2 diteve pune dhe do të kryhet nga strukturat pergjegjese te Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
  - n. Në rast së gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen atëherë aplikanti ose subjekti i autorizuar është i detyruar me shpenzimet e tij të riparoj pjesën e demtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotët funksionojë normalisht.
  - o. Nëse klienti shfrytëzon hapësirat e nenstacioneve për të instaluar pajisjet e tij si në godina dhe jashtë, duhet të paguajë një tarifë qeraje e cila arrihet me një marrëveshje ndërmjet paleve me një tarifë të përcaktuar nga ERE.

## 2.2 Projektimi

- a. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, Klienti apo Aplikanti do të përgatisë projektin e objektit që do të lidhet me Sistemin Shpërndarës si edhe projektin e linjes dhe kabines elektrike në perputhje me kerkesat teknike të përcaktuara nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike, në bazë të një tarifë të përcaktuar nga ERE.
- b. Projekti i paraqitur duhet të respektojë të gjithë legjisllacionin në fuqi, vecanerisht parimet e mbrojtjes së sigurimit teknik dhe sigurisë së punës të instalimeve elektrike përtë garantuar që shtesa që do të bëhet në rrjetin e Shpërndarjes të jete në gjendje të shfrytëzohet dhe mirëmbahet në mënyrë të sigurtë dhe efektive.
- c. Për përcaktimin e vendodhjes së kabines së transformimit, Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të marrë në konsideratë mundësinë e hyrjes pa probleme në ambient, duke insistuar që hyrja e tij të jete jashtë pronesisë të klientit si dhe përjashtimin e faktoreve që lidhen me zhurmat dhe rrezikun nga përmbajtjet në perputhje me standartet teknike të miratuara të kompanisë. Vendodhja e kabines duhet të jete në nivelin zero.
- d. Pajisjet që do të realizojnë lidhjen e re duhet të jenë të reja dhe parametrat nominalë të tyre përcjellesat, kabllot, transformator, cila TM, Panele të TU, mate TP.P, etc) duhet të jenë në perputhje me tipin dhe kerkesat teknike të parashikuara në standartet teknike të kerkuara nga Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
- e. Tokëzimi i kabines së transformimit do të jete konform legjisllacionit në fuqi dhe rezistenca ohmike e saj do të jete konform rregullave të sigurimit teknik.
- f. Tokëzimi i shtyllave për rrjetin ajror të tensionit të mesëm do të kene rezistenca tokëzimi të perseritur do të jete konform rregullave të sigurimit teknik.

### **2.2.1 Procedura për zhvendosjen e asetëve të Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike**

- a. Për nevojat të ndryshme të subjekteve mund të kërkohet të zhvendosen ose të zëvendësohen asetet e ndryshme të kompanisë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike si p.sh.: (Linje ajrore, linje kabllore, shtylla, kabina elektrike etj).
- b. Realizimi i zëvendësimit apo i zhvendosjeve të tilla do të bëhet vetëm pas miratimit paraprak të Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike në përputhje me Procedurat dhe Afatet e përcaktuara në pikat 2.1, 2.3 dhe 2.4 të kësaj Rregulloreje.
- c. Nëse Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike do të miratojë zhvendosjen atëherë ajo do të kryhet sipas kushteve teknike të vetë kompanisë dhe të gjitha shpenzimet për realizimin e zhvendosjes së asetëve do të perballohen nga aplikanti sipas preventivit të miratuar nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike .
- d. Pajisjet e lidhjes së re sigurohen, instalohen dhe testohen nga subjekti i pavarur i autorizuar nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike.

### **2.3 Menyra e lidhjes në rrjet të burimeve të energjisë**

- a. Burimet e energjisë elektrike do të lidhen në rrjetin shpërndarës pasi Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike të ketë kryer studimin e lidhjes dhe efektet që sjellin në atë pjesë të rrjetit prania e burimeve të reja të gjenerimit të energjisë elektrike.
- b. Burimet e reja do të preferohen të lidhen si pjesë shtesë e rrjetit ekzistues 6-10-20-35 kV dhe nëse kjo mënyrë lidhjeje është e pamundur atëherë do të realizohet lidhja e tyre në N/Stacionet e transformimit.
- c. Të gjitha shpenzimet që lidhen me realizimin e lidhjes, përfshirë edhe pjesën eksistuese të rrjetit shpërndarës për efekt të realizimit të lidhjes, shtesat e mundshme në pjesën e tensionit të mëtejshëm 35 kV dhe të tensionit të lartë në N/Stacione (kur kërkohet lidhja në to) do të perballohen nga aplikanti.

## **PJESA E III: DOKUMENTAT QË KERKOHEN PËR APLIKIM**

### **3.1 Dokumentacioni për lidhje të re në tension të ulët fuqi instaluar deri në 20 kW**

- a. Kërkese për furnizim me energji elektrike (Formulari i Aplikimit)
- b. Vertetim i identitetit (fotokopje e Kartës së Identitetit)
- c. Fotokopje e Certifikatës së regjistrimit në QKR (Për subjektet jofamiljare)
- d. Gen-Plani i vendosjes së objektit.
- e. Kopje e kontratës (karteles) së mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur.
- f. Vertetim i pronësive së objektit nepermjet dokumentave të regjistrimit të pronës, të tilla si: Akt shitje, akt qeraje, akt dhurimi ose akt ndarje prone të patundshme.

### **3.2 Dokumentacioni që kërkohet për fuqi të instaluar 21-50 kW.**

- a. Dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 3.1 si dhe dokumentat e tjera të mëposhtme:
- b. Projekti elektrik i cili përmban vetëm objektin për të cilin po aplikohet për lidhje të re.
- c. Plan- vendosja e të gjitha pajisjeve në objekt.

- d. Parametrat nominal të të gjitha pajisjeve elektrike të përfshira në projektin elektrik
- e. Licence e inxhinierit elektrik i cili ka bërë projektin elektrik të objektit.
- f. Raporti i detajuar inxhinierik në lidhje me projektin dhe përlogaritja e të dhënave të kryera nga inxhinierë me licence.

### 3.3 Dokumentacioni që kërkohet për fuqi të instaluar mbi 50 kW

- a. Dokumentacioni i kërkuar sipas pikës 3.2 si edhe dokumentat e tjera të mëposhtme:
- b. Leje e ndërtimit të objektit që kërkohet të furnizohet me energji elektrike
- c. Grafiku i ngarkesës elektrike
- d. Relacioni analitik për vlerësimin e  $\cos\Theta$  dhe kompesimin e saj.

### 3.4 Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese

- a. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (Formulari i Aplikimit)
- b. Fotokopje e Vertetimit të identitetit (Karte identiteti)
- c. Certifikate regjistrimi në QKR (Për subjektet jofamiljare)
- d. Gen-Plan i vendosjes së objektit.
- e. Hartë që të tregojë vendodhjen e objektit në terren nënjë shkallë të përshtatshme
- f. Profilin gjatësor të linjes elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
- g. Projektin e plotët të njëjës së si do lidhet objekti i ri në rrjetin shpërndarës.
- h. Kopje të Licenses së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
- i. Kopje e kontratës (karteles) së mëparshme që aplikanti mund të ketë pasur.
- j. Kontrata e koncesionit për ndërtimin e birit gjenerues.
- k. Llojin e burimit gjenerues dhe parametrat nominale të tij përfshirë edhe X(d)
- l. Fuqia maksimale e gjeneruar aktive dhe reaktive.
- m. Skema principale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike
- n. Tipi i gjeneratorit sinkron dhe parametrat e tij.
- o. Parametrat kryesore të transformatorit të fuqisë.

### 3.5 Projektimi i kabines së transformatorit dhe mënyrës së lidhjes nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike sh.

- a. Për Piken e Lidhjes së miratuar, Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike do të kryejë projektin ndërtimor dhe atë elektrik për kabinen e transformatorit (n.q.s është parashikuar në ofertën e Operatorit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike dhe mënyrën e lidhjes së saj me rrjetin e Shpërndarjes.
- b. Projekti do të përmbajë të gjitha kërkesat siç specifikohen më poshtë:
  - Planimetria dhe vendodhja e kabines së transformimit si pjesë perberëse e projektit ndërtimor në teresi
  - Projektimi ndërtimor i detajuar i pikës së transformimit (përfshirë të gjitha prerjet terthore të godinës së kabines)
  - Plani i vendosjes i të gjitha pajisjeve brenda pikës së transformimit.
  - Planimetria e vendosjes së kabllëve elektrike brenda dhe jashtë kabines, si edhe prerja terthore e kanaleve të kabllëve.
  - Skema elektrike principale e kabines elektrike, duke pasqyruar të gjithë parametrat nominale të pajisjeve elektrike, si edhe të gjitha detajet e tjera që lidhen me realizimin në teresi të saj.

- Sistemi i tokëzimit të kabines dhe të gjitha detajet që lidhen me realizimin e tij, brenda dhe jashtë kabines elektrike.
  - Projektimi i linjave ajrore, linjave kabllore të fuqisë (TM-TU) dhe profili i linjes në shkallën 1:1000
- c. Projektimi dhe perzgjedhja e pajisjeve do të bëhet në përputhje me tipin dhe specifikimet teknike të bera të njohura paraprakisht nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes pas pranimit të ofertës nga ana e aplikantit.

### **3.6 Vlefshmeria e dokumentacionit të paraqitur**

- a. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. (duhet të arshivohet nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike shpesh vetëm një fotokopje e tyre).
- b. Nëse nga vlerësimi paraprak i të dhënave të mesipërme dokumentacioni i paraqitur konsiderohet i pamjaftueshëm atëherë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike ka të drejtë të kërkojë aplikuesit të dhëna shtesë.

## **PJESA E IV: TARIFAT PËR LIDHJET E REJA**

### **4.1 Parimet e tarifave**

- a. Tarifat për lidhjen me rrjetin e Shpërndarjes së energjisë elektrike janë përcaktuara në përputhje me objektivat e mëposhtme:
  - Mos-diskriminim
  - Transparencë që lidhet me përdorimin e rrjetit të Shpërndarjes së energjisë elektrike dhe pjesëve integrale të tij,
  - Zhvillimin e rrjetit të Shpërndarjes, në mënyrë që të sigurohet ruajtja e nivelit të cilësive së furnizimit me energji elektrike
- b. Tarifat për Lidhjet e Reja janë të njëjta për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë
- c. Parimi kryesor për detyrimin për realizimin e Lidhjes së Re është: Ai person fizik apo juridik që kërkon ndryshime në rrjetin e Shpërndarjes, do të mbulojë të gjitha shpenzimet që lidhen me ndryshimin e rrjetit të Shpërndarjes për të realizuar lidhjen e re.

### **4.2 Punimet shërbimet që do të paguhën nga aplikanti**

- a. Aplikuesi do të paguajë koston që lidhet me shërbimet që do të kryhen nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike si dhe subjektet e autorizuara nga ai, dhe që përfshihen në tarife, si më poshtë:
  - Pranimit dhe procesimi aplikimit
  - Planifikimi i zhvillimit të rrjetit të Shpërndarjes për të mundësuar lidhjen e objektit të ri;
  - Përcaktimi i pikes së lidhjes në Sistemin e Shpërndarjes;
  - Kontrollin e Miratimit të projektit të paraqitur nga Aplikanti;
  - Furnizimin dhe instalimin e pajisjeve të përfshira në lidhje të reja të cilat do të realizohen nga subjekti i autorizuar nga Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, kolaudimin e tyre si edhe testimin e të gjitha pajisjeve të përfshira në lidhjen e re.
  - Inspektimi, monitorimi i Punimeve ndërtimore dhe instalimeve



- Instalimi i aparateve matëstëenergjisë elektrike,
  - 50 ml kabell (koaksial ose fuqie sipas rasteve) për instalimin e matësit në abonentet e pajisur me matës energjie me boks individual etj.
  - Lidhja me rrjetin e Shpërndarjeste Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike.
  - Verifikimin e matesit te energjise elektrike, vulosjen e bokseve individuale, vulosjen e transformatoreve mates te rrymes dhe tensionit.
- b. Punimet Sherbimet që do të kryhen dhe perballohen nga Aplikanti janë:
- Projektimi e lidhjes së re
  - Kryerja e të gjithë punimeve me karakter ndertimor (kabina, kanalet e kablllove, etj)
  - Koston e pjeses së kabllit me shumësë 50 ml, vlera e të cilit do tëpercaktohet referuar cmimit mesatar të ketij kablli në librat e Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike. (Abonentet e pajisur me matës energjie me boks individual)
  - Hapja e kanaleve të kablllove për realizimin e nyjeve bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojne lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, mufte, etj), si dhe rehabilitimin (e perkohshem dhe të perhershem) të terrenit, duke perfshire edhe sistemet rrugore.
  - Testimi i lidhjes së realizuar.
  - Lejet e duhura për ciklin e punes

### 4.3 Menyra e pagesës

- a. Aplikanti duhet të kryeje një pagese për tarifen e lidhjes së re e cila mbulon shpenzimet e percaktuara si me siper.
- b. Aplikanti do të mbuloje vete shpenzimet e të gjitha punimeve dhe pajisjeve shtesëqëjanëtë nevojshme përtë realizuar lidhjen e re.
- c. Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrike do të zbatoje praktiken e pageses sëplotënë avance përtë gjitha lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese.
- d. Në fund të kryerjes së punimeve Operatori i Shpërndarjes te Energjise Elektrikedo tëpërgatisënjë fature të detajuar të kostove sasive dhe cmimeve të punimeve dhe materialeve të perdorura faktikisht për realizimin e lidhjes së re ose modifikimin e një lidhje ekzistuese.
- e. Tarifa e T3 për fuqine e kerkuar e cila paguhet nga aplikanti, nuk mund të jete me e larte së 300% e të ardhurave për fryme. Mbulimi i pjeses tjeter të tarifes që kalon shumën e përcaktuar me siper, do të jete objekt i rregullimit nga ERE.

### 4.4 Struktura e tarifave të lidhjes së re

- a. Tarifat përnjë lidhje të re ose modifikim lidhjeje ekzistuese (Tarifat e Lidhjes) do të llogariten duke marre parasysh parimet e percaktuara nëkëtë rregullore
- b. Tarifat e Lidhjes do të varen nga kerkesat e aplikantit, disponibiliteti i rrjetit tëShpërndarjes tek pika e lidhjes, fuqi rezerve (nese ka) tek pika e lidhjes dhe karakteristika të tjera që lidhen me realizimin e saj, duke perfshire fuqine e kerkuar dhe nivelin e tensionit

- c. Tarifat e Lidhjes perbehen nga tarifat e meposhtme:
- T1-** Tarifa e aplikimit qe lidhet me procesimin e tij
  - T2-** Tarifa e studimit dhe vleresimit e miratimit të projektimit
  - T3-** Tarifa e fuqise (leke për fuqi të kerkuar)
  - T4-** Tarifa përverifikimin dhe vulosjen/bashkevulosjen ematësit tëenergjisë elektrike
  - T5-** Tarifa e sherbimit per pajisjet elektrike, instalimin e tyre, kolaudimin dhe testimin e cila varet nga tipi i kabines, struktura e pajisjeve te saj, fuqia transformuese, numri i celave, menyra e matjes se energjise elektrike, dhe nivelit te tensionit.
  - T6-** Tarifa per km e ndertimit te linjave TM-TU, e cila varet nga niveli i tensionit dhe tipologjia e linjes.
  - T7-** Tarifa e projektit te pikes te lidhjes.

#### 4.5 Kushtet të tjera për lidhje në rrjetin shpërndarës

- a. Rrjeti trefazor i tensionit tëulët 0.4 kV**
  - Fuqia minimale e instaluar përtë realizuar lidhjen e energjisë elektrike në tension tëulët 0.4kV do të jete deri 5 kW për rrjetin 1 fazor dhe mbi 5 kW për rrjetin 3 fazor.
- b. Rrjeti i tensionit 6 dhe 10 kV**
  - Rrjeti i tensionit 6 dhe 10 kV është në proces kalimi dhe transferimi në rrjetin me shkalle tensioni 20 kV.
  - Menyra e realizimit të lidhjeve të reja në rrjetin e tensionit tëmesëm 6, 10 kV, kur parashikohet ndertimi i kabines elektrike, do do realizohet nepermjet celave (panelave) të TM sipas struktures: Çele Hyrje- Çele Dalje dhe Çele Transformatori.
  - Aplikanti do të jete vete pergjegjes për ndryshimin e pajisjeve dhe kryerjen e punimeve nësenëtë ardhmen ky rrjet shpërndarëspranë objektit qëështë lidhur do të zevendesohet me rrjetin 20 kv.
- c. Rrjeti i tensionit 20 kV**
  - Lidhja e kabinave elektrike në rrjetin shpërndarës me tensionin 20 kV do realizohet nepermjet celave (panelave) të TM sipas struktures: Çele Hyrje- Çele Dalje dhe Çele Transformatori.
- d. Kabinat shtyllore 6, 10, 20kV**
  - Kabinat shtyllore do të perdoren kryesisht në zonat rurale por ato mund të ndertohen edhe në zona urbane, në varesi të analizes dhe vendimit tëvete Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike
  - Menyra e realizimit të tyre do të jete sipas skemes Thike-Sigurese-Shkarkues dhe fuqia e transformatorit të fuqise do të jete 50-400 kVA.
  - Nëse disa konsumatorë kane kontratëtë vlefshme furnizimi me energji elektrike dhe kerkojne të ndertojne një kabine nëzonë rurale me qellim permiresimin e cilesise së furnizimit, atëherëOperatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të miratoj kerkesen e tyre, pavaresisht së keta konsumatorë mund të mos kene dokumentat që vertetojne legalizimin e baneses së tyre. Në keto raste do të transferohen asetet e lidhjes në pronesi te Operatori i Sistemit tëShpërndarjes.
- e. Rrjeti i tensionit 35 kV**
  - Pranimi dhe menyra e realizimit të lidhjeve të reja në rrjetin e tensionit

- 35 kV do të behen në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe rregullat e brendshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Menyra e realizimit të tyre do të jetë sipas skemës Thike-Sigurese-Shkarkues dhe fuqia minimale e transformatorit të fuqisë për të pranuar vlerësimin e aplikimeve në këtë rrjet tensioni do të jetë mbi 800 kVA.
  - **Fuqizimi i kabinave të transformimit 6.10, 20 kV në pronesi të Operatorit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike** kryhen analizën dhe vlerësimin së njësive të transformimit që ndodhen pranë vend ndodhjes së objektit të ri që kërkon lidhje të re apo shtesë fuqie.
  - Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike do të vlerësojë çdo rast dhe në varesi të gjendjes së rrjetit, gjendjes së kabines eksistuese, mundësive reale për transformatore fuqie reserve; perspektivës së zhvillimit në atë zonë; ai (Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike) mund të vendosë të bëjë vetë fuqizimin e kabines eksistuese dhe aplikanti të lidhet në tensionin e ulët duke paguar tarifën respektive.

#### 4.6 Tarifat për lidhje në tension të ulët

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të ulët 0.4 kV

##### a. Konsumatorë Familjare

T1= 0 Lek

T2= 1.200 Lek

T3=2.000 Lek/ kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4= Tarifa për verifikimin dhe vëlosjen e matësit të energjisë elektrike

##### b. Konsumatorët Jofamiljare

T1= 0 Lek

T2= 1.200 Lek

T3= 2.500 Lek kW (kundrejt fuqisë së kërkuar)

T4= Tarifa për verifikimin dhe vëlosjen e matësit të energjisë elektrike

##### c. Në lidhje me koston e kabllit

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka detyrimin të ofrojë pa pagesë aplikantit kabllin koaksial 2 x 6 mm<sup>2</sup> për instalimin e boksit individual me matësnjë fazor përnjë gjatësi deri në 50 m.
- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka detyrimin të ofrojë pa pagesë aplikantit kabllin e tensionit të ulët (PVC) përnjë gjatësi deri në 50 m.
- Nëse distanca deri tek pika e lidhjes është me shumë më shumë se 50 m atëherë aplikanti detyrohet të paguajë koston shtesë për efekt të gjatësisë së kabllit mbi 50 m, sipas cmimit njësi mesatar të regjistruar në Operatorin të Sistemit të Shpërndarjes përkëtë artikull, dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të lëvrojë dhe instalojë kabllin, pa shkeputje, deri tek pika e lidhjes.

#### 4.7 Tarifat për lidhje në tension të mesëm

Kjo tarifë aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension të mesëm 6, 10 dhe 20 kV

T1= 4.000 Lek

- T2= 1.200 Lek
- T3= 1.700 Lek kW (kundrejt fuqise së kerkuar)
- T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike
- T5= Tarifa për kabinen elektrik
- T6= Tarifa per km e ndertimit te linjave TM-TU, e cila varet nga niveli i tensionit dhe tipologjia e linjes.**
- T7= Tarifa e projektit te pikes te lidhjes**

#### **4.8 Tarifa për lidhje në tension tëmesëm 35 kV**

Kjo tarife aplikohet për rastet kur aplikantit i miratohet lidhja në tension tëmesëm 35 kV

- T1= 4.000 Lek
- T2= 1.200 Lek
- T3= 2.000 Lek kW (kundrejt fuqise së kerkuar)
- T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike
- T5= Tarifa për kabinen elektrik
- T6= Tarifa per km e ndertimit te linjave TM-TU, e cila varet nga niveli i tensionit dhe tipologjia e linjes.**
- T7= Tarifa e projektit te pikes te lidhjes**

#### **4.9 Tarifa përshtesë fuqie**

##### a. Konsumatorë Familjare

- T1; T2;= 0 Lek
- T3= 2.000 Lek kW (kundrejt fuqise së kerkuar)
- T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike

##### b. Konsumatorët Jo-familjare në tension tëulët

- T1; T2;= 0 Lek
- T3= 2.500 Lek kW (kundrejt fuqise së kerkuar)
- T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike

##### c. Konsumatorët Jo-familjare në tension tëmesëm

- T1; T2;= 0 Lek
- T3= 1.700 Lek kW (kundrejt fuqise së kerkuar)
- T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike

##### d. Konsumatorët Jofamiljare në tension 35 kV

- T1; T2;= 0 Lek
- T3= 2.000 Lek kW (kundrejt fuqise së kerkuar)
- T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike

#### **4.10 Tarifat për modifikim ose transferim lidhjeje**

Kjo tarife do të aplikohet vetem për konsumatorët jo familjare dhe sherben për rastet kur konsumatori është i lidhur në rrjet dhe ka paguar tarifat e lidhjes por kërkotë transferoj piken e lidhjes ose nënjë vendndodhje tjetër ose nënjë tjetër shkalle tensioni të rrjetit shpërndarës.

Në raster kur kërkohet lidhja në rrjet nënjë tjetër shkalle tensioni atëherë konsumatori është pergjegjes për ndryshimin e parametrave tëtë gjithë aseteve që realizojne lidhjen në shkallen e re të tensionit.

- a. Konsumatorë Familjare  
T1; T2= 0 Lek  
T3= 2.000 Lek kW (kundrejt fuqise së modifikuar)  
T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike
- b. Konsumatorët Jofamiljare në tension të ulët  
T1; T2= 0 Lek  
T3= 2.500 Lek kW (kundrejt fuqise së shtuar)  
T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike
- c. Konsumatorët Jofamiljare në tension të mesëm  
T1; T2= 0 Lek  
T3= 1.700 Lek kW (kundrejt fuqise së shtuar)  
T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike
- d. Nëse një konsumator jo familjar ka realizuar një lidhje të re në një vendodhje të caktuar dhe kërkon ta transferoj atënjë tjetër vend apo në tjetër njësi administrative atëherë atij i njihen tarifën e lidhjes së re të meparshme por mbetet i detyruar të paguaj prej tyre vetëm tarifën T1, T2 sipas pikës 5.10.5. Nëse kjo levizje do të shoqërohet edhe me shtesë fuqie atëherë aplikanti detyrohet të paguaj T1, T2 si më sipër si edhe vlerën e shtesës së fuqise.

#### 4.11 Tarifat për lidhje në N/ Stacione

Lidhja e re në zbarat e rrjetit shpërndarës të N stacioneve mund të kryhet duke vlerësuar paraprakisht gjendjen ekzistuese të N Stacionit dhe mundësinë e lidhjes në të.

- a. Nëse Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike shpërndarës të Energjisë Elektrike shpërndarës të Energjisë Elektrike sha. Disponon çelë në impiantin shpërndarës atëherë aplikanti do të detyrohet të përballojë jo vetëm shpenzimet për ndryshimin e paisjeve (Transformator rryme, koke kabllit etc), por edhe këto tarifa shtesë:
 

Tarifa e përdorimit të çelës ekzistues	150'000 Leke
Tarifa modifikim lidhjeje	50'000 Leke
- b. Nëse Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike nuk disponon çelë impiantin shpërndarës atëherë aplikanti do të sigurojë dhe instalojë vetë çelë në objekt dhe detyrohet të paguaj:
 

Tarifa modifikim lidhjeje	50'000 Leke
---------------------------	-------------
- c. Nëse Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike do të instalojë vetë një çelë në objekt për të realizuar lidhjen e kërkuar atëherë aplikanti do të detyrohet të paguaj:
 

Tarifa e përdorimit të çelës	150'000 Leke
Tarifa modifikim lidhjeje	50'000 Leke
- d. Për të gjitha rastet e mësipërme matja dhe faturimi i energjisë elektrike do të bëhet nëpërmjet një paneli matjeje të vendosur në N /Stacion sipas kushteve të percaktuara në Kodin e Matjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike është përgjegjës për sigurimin dhe instalimin e sistemit matës respektiv.

#### **4.12 Tarifa për rastet e lidhjes nga disa burime tëenergjisë elektrike**

Operatori i Sistemit tëShpërndarjes do të aplikoje një tarife shtesëpër rastet kur kërkohet dhe miratohet realizimi i lidhjes së re nga dy burime energjie të pavarurua. Për keto raste, Përdoruesi ose Aplikanti do të paguaje tarifen perkatese për secilen lidhje sipas kesaj Rregulloreje. Procedura dhe kushtet do të jenë të njejta sikurse në rastin kur lidhja do të realizohet nga një burim i vetem furnizimi.

#### **4.13 Tarifa T4 përverifikimi dhe vulosjenematësit tëenergjisë elektrike**

Tarifa T4 e verifikimi dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike do të paguhet nga aplikanti dhe perfsin:

- Verifikimin e matesit te energjise elektrike nga subjekti i autorizuar
- Vulosjen e makinerise se matesit elektrik nga subjekti i autorizuar
- Bashkevulsojen e morseterise nga Operatori i Sistemit te shperndarjes dhe nga subjekti i autorizuar
- do të behet në prezence të subjektit të autorizuar
- Tarifat e sherbimeve te mesiperme jane te miratuara nga Ministria e Financave.

#### **4.14 Tarifa T5 për ndertimi e kabines elektrike**

Tarifa T5 qe lidhet me ndertimin e kabines elektrike ( pajisjet, instalimi, kolaudimi, testimi) percaktohet si vijon:

#### **4.15 Tarifa T6 per ndertimin e linjave TM-TU**

Tarifa T6 qe lidhet me ndertimin e linjave te tensionit te mesem dhe te ulet percaktohet si me poshte:

#### **4.16 Tarifa T7 per projektimin e kabinave dhe linjave te furnizimit**

Tarifa T7 qe lidhet me projektimin e kabinave dhe linjave te furnizimit percakrohet si me poshte:

#### **4.17 Tarifa lidhjen e burimeve të gjenerimit tëenergjisë elektrike**

Për rastin kur në Sistemin e Shpërndarjes do të lidhen burime të gjenerimit tëenergjisë elektrike, tarifa e lidhjes do të perbehet vetem nga keto komponente:

T1= 10'000 Lek

T2= 100'000 Lek

T3= 0

T4= Tarifa për verifikimin dhe vulosjen e matësit të energjisë elektrike Në rast së lidhja e burimeve tëenergjisë do të behet në zbarat e rrjetit shpërndarës N / Stacioneve në pronesi te Operatorit të Sistemit tëShpërndarjesatëherë do të aplikohen edhe tarifate shtesë sikurse janëpërcaktuarme siper..

#### **4.18 Kontrolli i kerkeses maksimale për fuqi**

- a. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të kontrolloje kerkesen maksimale për furnizim me energji elektrike nga cdo konsumator i lidhur në tension tëulët duke perdorur Automat ngarkese.

- b. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike do të kontrolloje kerkesen maksimale nga cdo konsumator i lidhur në tension tëmesëm duke perzgjedhur koeficientin e pershtatshem të transformimit të Transformatorit të Rrymes.
- c. Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike është pergjegjes për të siguruar dhe instaluar sistemin e matjes (boks individual me matës, boks kolektiv me matës, matës, trasformatoret e rrymes, cele e matjes së bashku me transformatorët e rrymes dhe ata të tensionit, në objektin qëkërkohet të lidhet me energji elektrike, në kabinën elektrike dhe në N/ Stacionin elektrik, etc)

## **PJESA V: PRONESIAPËR LIDHJET E REJA**

### **5.1 Kufijte e pronesise**

- a. Për sa i perket Përdoruesve ose Aplikanteve që kërkojnë pike lidhjeje në Tension tëMesëm, kufijte e pronesise do tëjenë tëpërcaktuarnë cdo rast nga Marrëveshjetë vecanta ndermjet paleve
- b. Linjat e lidhjes të Tensionit tëUlët dhe ato të Tensionit tëMesëm dhe pajisjet e kabines se transformimit si asete të lidhjes do tëjenë gjithmone prone e Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.
- c. Subjekti privat i transferon të gjitha asetet e lidhjes (Pajisjet elektrike të kabines) Operatorit te Shperndarjes te Energjise Elektrike si dhe perdorimin e hapesires te kabines pa pagese,pa te drejte ndryshimi destinacioni. Ne momentin qe ndertesa e kabines dhurohet pasi eshte hipotekuar tek Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike , ky i fundit kompeson Poseduesin e meparshem të kabines për pjesen e Tarifes T3 që i korespondon fuqise së kerkuar nga Poseduesi i ri.

### **5.2 Marreveshja për kalimin e pronesise**

- a. Subjekti pronar i kabines dhe Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike transferojne pajisjet elektrike të kabines elektrike nga pronari tek Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike pa pagese, dhe ne momentin qe bien dakort per te kaluar pronesine e kabines , atëherë Operatori i Sistemit tëShpërndarjes do të kompesoje pronarin me vleren e tarifes së fuqise (T3).
- b. Nëse aplikanti ka ndertuar një objekt të meparshem për të cilin ka ndertuar edhe kabinën elektrike dhe kërkotë lidh edhe një tjetër objekt të ri në po atë kabine, atëherë kompesimi do të behet për tarifen T3 të objektit të pare dhe atë të objektit/ objekteve të ri/ reja. Aplikanti mund të fuqizoj paraprakisht kabinën ekzistuese në pronesi të tij për të lidhur objektin tjetër dhe kompesimi do të behet po sipas pikes 5.2.a duke u kompesuar jo vetem për objektin/ objektet e meparshme por edhe për objektin/objektet e reja.
- c. Tarifa T3 për objektet e reja do të paguhet paraprakisht kurse kompesimi me tarifen T3, e parashikuar sipas pikave 5.2.a dhe 5.2.b do të kryhet vetem pasi aplikanti tëkë të nenshkruar me Operatorin e Sistemit tëShpërndarjes, kontratën e shitblerjes së pasurive tëpaluajtshme.
- d. Operatori i Sistemit tëShpërndarjes do të zbatoje kompesimin nepermjet tarifes T3 edhe në rastet kur pronari nuk disponon certifikaten e pronesise mbi kabinën elektrike, por e dokumenton atë nepermjet Marrëveshjes së Lidhjes me Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike.

- e. Në rast sënjë apo disa Përdorues apo Aplikante kerkojne të ndertojne një kabine të re transformimi për nevojat e tyre, të gjitha shpenzimet për realizimin e kesaj lidhjeje të re do të perballohen nga vete Përdoruesi apo Aplikanti. Njëkëtë rast ata duhet të nenshkruajne një Marrëveshjetë perbashket dhe duhet qëtë transferoje asetet tek Operatori i Shperndarjes te Energjise Elektrike duke ju falur tarifa T3 përkëtë lidhje të re, nepermjet Kontratës së shitblerjes së pasurive të luajtshme.

### **5.3 Të drejtat e pronesise mbi pasurine e paluajtshme**

- a. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të bleje ose tëkëtëtë drejten e uzufuktit pa shperbim mbi pasurine e paluajtshme me destinacion kabine elektrike
- b. Uzufukti do të krijohet me Marrëveshje noteriale midis paleve përnjë afat 30 vjecar, me të drejte ripeteritje dhe do të regjistrohet në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Ndryshimi i pronarit të pasurise së paluajtshme nuk do të cenoje të drejten e uzufuktit te Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- c. Marreveshja e Uzufuktit midis paleve do të realizohet në perputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqiperise, (ligji 7850 date 29.07.1994 i ndryshuar).

## **PJESA VI: SUBJEKTET E AUTORIZUARA**

- 6.1 Pajisjet, sherbimi i instalimit, kolaudimit dhe testimit e pajisjeve qe lidhen me realizimin e lidhjes se re kryen nga subjekte te pavarura qe nuk perfshijne Operatorin e Shperndarjes te Energjise Elektrike.
- 6.2 Subjektet e pavarura per realizimin e lidhjes se re autorizohen paraprakisht nga Operatori i Sistemit te Shperndarjes per te kryer sherbimin e parashikuar ne kete rregullore.
- 6.4 Tarifat e sherbimit te subjekteve private jane percaktuar ne kete rregullore dhe ne aktet e tjera ligjore ne fuqi.
- 6.5 Në rast së gjatë vënies në tension të objektit lindin probleme në pajisjet që realizuan lidhjen e re atëherë subjekti i autorizuar për instalimin e lidhjes se re është i detyruar me shpenzimet e tij të riparoj pjesen e demtuar ose jo funksionale deri sa skema e plotë të funksionoj normalisht.
- 6.6 Testimi i pajisjeve elektrike qe lidhet me realizimin e lidhjes se re duhet te behen domosdoshmerisht duke perdorur instrumenta te kalibruar nga nje laborator i pavarur i akredituar me ISO IEC 17025:2005

## **PJESA VII: DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

- 7.1 Asetet epaluajtshme të perfituara “pa shperblim” nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas kesaj Rregullore nuk do të perfshihen në Bazen e Regulluar të Aseteve, për efekt të llogaritjes së tarifave.
- 7.2 Kjo rregullore është objekt rishikimi, me vendim të Bordit të Komisionereve të ERE-s, sipas Rregullores së Praktikes dhe Procedurave të ERE-s.
- 7.3 Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare